


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Nëntor 2017

**Tiranë, më 18 Dhjetor 2017:** Në Nëntor 2017 eksportet e mallrave arritën vlerën 25 mld lekë, duke u rritur me 11,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 2,3 %, në krahasim me Tetor 2017. Importet e mallrave, në Nëntor 2017, arritën vlerën 54 mld lekë, duke u rritur me 10,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me 5,3 %, në krahasim me Tetor 2017. Deficiti tregtar i këtij muaji është 29 mld lekë, duke u rritur me 9,3 %, krahasuar me Nëntor 2016 dhe duke u ulur me 11,1 %, në krahasim me Tetor 2017.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në njëmbëdhjetë muajt e parë eksportet e mallrave arritën vlerën 251 mld lekë, duke u rritur me 13,2 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 565 mld lekë, duke u rritur me 8,0 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 314 mld lekë, duke u rritur me 4,1 %, krahasuar me 2016.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Rritja vjetore e eksporteve prej 11,0 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +5,2 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +3,1 pikë përqindje. Grupet që kanë ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -6,0 pikë përqindje dhe “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,1 pikë përqindje.

**Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Nëntor 2017**




Eksportet, gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori, janë rritur me 13,2 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +4,4 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -0,5 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rritja vjetore e importeve prej 10,1 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +2,1 me pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +2,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -1,2 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Nëntor 2017**



Si njëmbëdhjetëmujor, importet janë rritur me 8,0 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin 2016. Të gjitha grupet kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, ku grupe që kanë ndikuar më tepër në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,3 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,3 pikë përqindje.

### **Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Nëntor 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Nëntor 2016, janë: Italia me (14,5 %), Kosova me (37,5 %) dhe Spanja me (26,8 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Kina me (-40,0 %), Maqedonia me (-1,5 %) dhe Serbia me (-1,1 %).

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (9,3 %), Kosova me (30,7 %) dhe Spanja me (107,2 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Turqia me (-8,7 %), Holanda me (-10,1 %) dhe Zvicër me (-55,6 %).

Në muajin Nëntor 2017, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Nëntor 2016 janë: Italia me (11,3 %), Kina me (17,3 %) dhe Turqia me (15,8 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Greqia me (-8,2 %), Spanja me (-17,1 %) dhe Shtetet e Bashkuara me (33,1%).

Gjatë këtij njëmbëdhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (6,1 %), Turqia me (11,8 %) dhe Greqia me (9,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Gjermania me (-5,4 %), Kina me (-2,8 %) dhe Franca me (-5,4 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Nëntor 2017



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 66,0 % të gjithë tregtisë. Në Nëntor 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 78,3 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 60,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (37,1 %), Kina (7,1 %), Gjermania (6,5 %) dhe Turqia (6,2 %).

Shkëmbimet tregtare, për njëmbëdhjetëmujorin 2017, me vendet e BE zënë 66,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Nëntor 2017, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 77,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,6 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (36,3 %), Greqia (6,9 %), Gjermania (6,9 %) dhe Kina (6,4 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2015	01 - 15	18	-0,6	35	0,9	-17	50,4
	02 - 15	18	-9,4	39	-0,8	-21	47,3
	03 - 15	22	4,1	44	4,6	-22	49,9
	04 - 15	21	-8,5	44	-1,4	-23	47,6
	05 - 15	24	-4,8	44	-8,0	-20	54,3
	06 - 15	24	7,4	49	-0,8	-25	49,3
	07 - 15	23	-1,6	52	11,1	-29	43,0
	08 - 15	15	-17,3	40	-10,0	-25	38,3
	09 - 15	20	-4,3	44	-7,1	-24	46,3
	10 - 15	20	-9,3	50	-4,2	-30	40,2
	11 - 15	19	-8,9	49	2,0	-30	39,7
	Janar – Nëntor 2015	225	-4,7	491	-1,4	-266	45,9
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-19	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	04 - 16	21	1,7	52	19,0	-31	40,7
	05 - 16	21	-14,8	52	16,7	-31	39,6
	06 - 16	23	-6,4	52	6,2	-29	43,5
	07 - 16	23	-0,2	50	-4,5	-27	44,9
	08 - 16	16	6,9	47	15,9	-31	35,3
	09 - 16	21	0,9	48	9,3	-27	42,8
	10 - 16	22	7,3	50	-0,8	-28	43,5
	11 - 16	23	17,5	50	1,0	-27	46,2
	Janar – Nëntor 2016	222	-1,6	523	6,5	-301	42,3
2017	01 - 17	19	15,5	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	04 - 17	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	05 - 17	24	18,2	56	7,4	-32	43,6
	06 - 17	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	07 - 17	25	9,9	55	9,6	-30	45,1
	08 - 17	18	12,3	49	6,2	-31	37,4
	09 - 17	24	17,0	53	10,9	-29	45,1
	10 - 17	25	14,4	58	15,5	-33	43,1
	11 - 17	25	11,0	54	10,1	-29	46,6
	Janar – Nëntor 2017	251	13,2	565	8,0	-314	44,4

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)**

	Eksporte				Importe			
	Nën-16	Nën -17	Jan.- Nën . 2016	Jan.- Nën.2017	Nën-16	Nën -17	Jan.- Nën . 2016	Jan.- Nën.2017
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>16.782</b>	<b>19.879</b>	<b>174.284</b>	<b>193.317</b>	<b>29.950</b>	<b>32.844</b>	<b>330.023</b>	<b>347.930</b>
Austri	161	194	1.102	1.524	427	458	6.035	6.073
Mbretëri e Bashkuar	105	43	482	388	373	617	3.775	4.982
Gjermani	802	961	7.565	10.016	3.546	4.234	48.951	46.332
Greqi	926	930	10.090	10.708	3.839	3.525	41.527	45.347
Itali	12.096	13.856	122.880	134.304	14.181	15.779	152.936	162.328
Spanjë	883	1.120	6.570	13.613	1.208	1.002	11.734	12.306
Kroaci	78	94	882	785	488	372	3.941	4.076
Të tjera të BE-së	1.729	2.682	24.712	21.977	5.888	6.857	61.123	66.486
Kinë	1.231	739	6.176	8.028	4.190	4.915	45.490	44.207
Kosovë	1.351	1.857	14.869	19.440	571	755	5.234	7.696
Maqedonia	627	617	5.878	7.784	650	813	6.954	7.993
Rusi	-	0	61	89	1.362	1.383	10.300	10.891
SHBA	122	552	1.477	2.920	691	462	9.697	7.814
Turqi	521	199	2.181	1.991	4.084	4.729	41.563	46.474
Ukrainë	4	34	203	452	308	176	3.207	2.919
Zvicër	411	77	2.360	1.047	561	1.324	6.424	11.395
Të tjera	1.822	1.432	14.173	15.889	7.135	7.098	64.574	77.882
<b>Gjithsej</b>	<b>22.870</b>	<b>25.387</b>	<b>221.662</b>	<b>250.957</b>	<b>49.501</b>	<b>54.499</b>	<b>523.465</b>	<b>565.201</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Nën-16	Nën -17	Jan.- Nën . 2016	Jan.- Nën.2017	Nën-16	Nën -17	Jan.- Nën . 2016	Jan.- Nën.2017
<b>Gjithsej</b>	<b>22.870</b>	<b>25.387</b>	<b>221.662</b>	<b>250.957</b>	<b>49.501</b>	<b>54.499</b>	<b>523.465</b>	<b>565.201</b>
Ushqime, piqe, duhan	2.775	3.480	23.202	27.513	8.403	8.938	91.143	96.985
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	5.145	3.768	41.113	39.923	4.493	5.586	45.530	57.377
Produkte kimike dhe plastike	415	438	4.050	4.408	6.102	7.118	72.502	79.115
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	238	223	2.453	2.699	1.540	1.797	15.846	17.312
Prodhime druri dhe letre	797	852	7.056	7.456	2.205	2.215	21.365	21.764
Tekstile dhe këpucë	9.050	10.250	98.302	108.060	7.267	8.312	72.452	79.390
Materiale ndërtimi dhe metale	2.744	4.047	28.592	40.104	5.555	6.465	68.645	70.971
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.068	1.633	10.409	13.886	11.862	11.281	116.773	119.651
Të tjera	639	696	6.485	6.909	2.074	2.788	19.209	22.636

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)**

	Itali		Kosovë		Spanjë		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
<b>Gjithsej</b>	<b>122.880</b>	<b>134.304</b>	<b>14.869</b>	<b>19.440</b>	<b>6.570</b>	<b>13.613</b>	<b>10.090</b>	<b>10.708</b>
Ushqim, pije duhan	7.401	7.659	2.250	2.538	797	761	2.116	1.824
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	8.219	7.323	3.174	4.744	2.585	10.054	394	298
Produkte kimike dhe plastike	1.188	1.272	1.181	1.130	1	14	402	520
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.188	2.032	0	7	6	84	61	45
Prodhime druri dhe letre	5.224	5.298	296	392	5	6	829	965
Tekstile dhe këpucë	77.738	84.274	81	114	2.621	2.413	4.265	4.901
Materiale ndërtimi dhe metale	11.390	14.851	6.123	8.754	517	270	1.523	1.410
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	6.816	8.413	625	669	24	2	131	385
Të tjera	2.716	3.183	1.138	1.092	14	9	370	360

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)**

	Itali		Turqi		Gjermani		Greqi	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
<b>Gjithsej</b>	<b>152.936</b>	<b>162.328</b>	<b>41.563</b>	<b>46.474</b>	<b>48.951</b>	<b>46.332</b>	<b>41.527</b>	<b>45.347</b>
Ushqim, pije duhan	15.623	16.501	4.817	5.108	4.010	3.998	12.725	12.578
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	17.054	15.083	1.002	1.570	474	762	5.897	6.748
Produkte kimike dhe plastike	15.331	17.097	5.825	6.589	6.002	7.025	6.897	7.208
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	12.413	13.453	332	328	4	33	127	75
Prodhime druri dhe letre	5.907	6.089	3.015	3.161	794	787	2.581	2.997
Tekstile dhe këpucë	36.359	39.416	13.604	14.750	2.379	2.474	3.299	3.600
Materiale ndërtimi dhe metale	15.262	18.144	5.593	5.790	12.602	5.737	6.258	8.329
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	29.902	31.071	5.617	7.075	21.143	23.611	2.393	2.184
Të tjera	5.085	5.474	1.758	2.104	1.542	1.905	1.349	1.629

# Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikën e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri